



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDIM

Nr. 4, datë 26.2.2019

**PËR DISA ÇËSHTJE TË RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
SË KONFERENCËS SË KRYETARËVE, DATË 26.2.2019**

Në mbështetje të neneve 12, 26 dhe 27 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Kuvendit

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDOSI:

I. Miratohet me mirëkuptim Programi i Punës së Kuvendit për periudhën 4 mars – 12 prill 2019 dhe i përcillet Kuvendit për njoftim në seancë plenare.

II. Miratohet me mirëkuptim Kalendar i Punimeve të Kuvendit për periudhën 4 – 22 mars 2019, me ndryshimet e propozuara në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve dhe i përcillet Kuvendit për njoftim në seancë plenare.

III. Kuvendi mblidhet në seancë plenare më 26.2.2019, ora 17.00, me rendin e ditës të seancës plenare të datës 21.2.2019, përcaktuar me urdhrin nr. 6, datë 19.2.2019.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gramoz Ruçi

